



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2020

**V E N D I M**

**Nr. 92, Datë 17/08/2020**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 42, datë 29.05.2020, e z. E. D., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”<sup>1</sup>, nga ana e Ujësstellës Mat sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi E.D. pretendon se ka qenë në marrëdhënie pune me Ujësstellës Mat sh.a. nga data 24.02.2017 deri në datën 17.03.2020. Ankuesi pretendon se mbështetur në kontratën individuale të punës nr. 428 Prot., datë 24.02.2017, ka punuar në pozicionin e “*hidraulikut manovrator*”, pranë kësaj shoqërie. Ai shprehet se me ardhjen në detyrë të administratorit të ri, të kësaj shoqërie ka filluar diskriminimi i tij për shkak të bindjes politike. Nëpërmjet shkresës nr. 80, datë 09.03.2020, Administratori i Ujësstellës Mat sh.a. e ka njoftuar ankuesin për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Nëpërmjet

---

<sup>1</sup> Referuar vërtetimit nr. 53, datë 20.05.2020, të lëshuar nga PD, Dega Mat rezulton se ankuesi është anëtar dhe aktivist i këtij subjekti politik.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

kësaj shkrese, ankuesit i është kërkuar të paraqitet për bisedime paraprake pranë mjediseve të shoqërisë brenda 3 ditëve duke filluar nga e nesërmja e marrjes dijeni për njoftimin. Në vijim, me Vendimin nr. 20, datë 17.03.2020, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me motivacionin “përfundim i afatit të kontratës individuale të punës”.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se largimi i tij nga puna lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me bindjet e tij politike, të djathta dhe me anëtarësinë e tij në Partinë Demokratike. Z. E.D. sqaron se kontrata e tij e punës ka qenë me afat të pacaktuar dhe se Ujësstellës Mat sh.a. nuk ka zbatuar afatet lidhur me procedurat e ndjekura për largimin e tij nga puna.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 42, datë 29.05.2020, së z. E. D., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Ujësstellës Mat sh.a. me shkresën nr. 635/1, datë 04.06.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
  - Akti i emërimit të tij, në pozicionin e hidraulikut manovrator pranë Ujësstellës Mat sh.a.;
  - Të gjitha kontratat individuale të punës të lidhura ndërmjet shoqërisë dhe ankuesit;
  - Praktika e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ku të përfshihen akti i njoftimit, procesverbali i takimit dhe vendimi i lirimit nga detyra;

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Informacion mbi numrin e punonjësve që janë larguar nga detyra pranë kësaj shoqërie me të njëjtin motivacion, sikurse ankuesi. Të dërgohen kopje të kontratave të tyre të punës dhe vendimeve respektive për zgjidhje të marrëdhënieve të punës.
1. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur të KMD-së, Ujësstellës Mat sh.a. ka dërguar shkresën nr. 210, datë 15.06.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se z. E.D. ka qenë në marrëdhënie pune pranë kësaj shoqërie me detyrë Specialist Hidraulik në Njësinë Administrative Ulëz pranë Drejtorisë Teknike që prej datës **02.07.2018** deri në datën **17.03.2020**, datë në të cilën është vendosur zgjidhja përfundimtare e marrëdhënieve të punës.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit, Shoqëria informon se me Urdhërin nr. 52, datë 13.12.2019, të Administratorit të Ujësstellës Mat sh.a z. E.D. është emëruar në detyrë pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë, pasi për të siguruar përshtatjen e punonjësve me strukturën e re, ka qenë e nevojshme të bëhet emërimi i punonjësve në pozicionet e reja të punës. Po, në datën 13.12.2019, nga ana e punëmarrësit u nënshkrua Kontrata Individuale e Punës me afat të caktuar për pozicionin e ri të punës, ku ishin të përcaktuara qartazi të gjitha detyrat reciproke të palëve. Kjo kontratë u hartua me një afat 3-mujor nga data 13.12.2019, deri me datë 13.03.2020. Në nenin 29, të Kontratës Individuale të Punës nr. 687, datë 03.08.2016, citohet shprehimisht: *“Në mbarim të afatit të sipërcituar ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër. Kjo kontratë u nënshkrua pa asnjë vërejtje nga palët, pasi u lexua dhe nga ankuesi ishte dakord për kohëzgjatjen e përcaktuar në kontratë.*

Në datën 09.03.2020, z. E.D. është njoftuar zyrtarisht për fillimin e procedurës për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe në datën 17.03.2020 është marrë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me motivacionin *“përfundimi i afatit të kontratës”*.

Në shkresën e Ujësstellës Mat sh.a. theksohet fakti se ankuesi nuk disponon asnjë dokument që e ka kryer punën e tij me përpikmëri, si dhe asnjë dokumentacion që të vërtetojë se është diskriminuar. Shoqëria Ujësstellës Mat sh.a. nuk ka asnjë informacion mbi anëtarësinë e z. E.D. në parti politike dhe në praktikën e ndjekur për lëvizjen e tij nuk është ndjekur asnjë kriter politik.

#### **4. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

##### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Mbështetur në aktet e depozituara në cilësi provë nga palët dhe specifikisht ne Kontratën Individuale të Punës, nr. 428, datë 24.02.2017, rezulton se ankuesi E.D.ka filluar punë në datën **24.02.2017**, në pozicionin “*punonjës shërbimi i pakualifikuar me kontratë të përkohshme*” pranë Sektorit të Ujësjellësit të Njësisë Administrative Ulëz. Marrëdhënia e punës për këtë pozicion pune rregullohet nga kontrata e sipërpërmendur, e lidhur ndërmjet ankuesit dhe Kryetarit të Bashkisë Mat. Kjo kontratë pune është me afat të caktuar 3 muaj, përkatësisht nga data **24.02.2017** deri në **datën 31.05.2017**. Në nenin 32, të kësaj kontrate përcaktohet shprehimisht: “*Pasi punëmarrësi u njoh me rregulloren e brendshme të institucionit, detyrat dhe kompetencat e tij, të dy palët bien dakord dhe me dëshirë e vullnet të lirë miratojnë këtë kontratë pune për një periudhë kohore nga data **24.02.2017** deri më datë **31.05.2017**. Në mbarim të afatit të sipërcituar, ndërprerja e marrëdhënëve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër”.*

Në nenin 6, të kontratës së mësipërme citohet: “*....Gjatë zbatimit të kontratës, Punëdhënësi mund të transferojë Punëmarrësin në vende pune ose detyra të tjera brenda Bashkisë Mat dhe institucioneve të tjera të varësisë. Paga që do të përfitojë në këto raste do të jetë sipas vendimit të ri të punës, në përputhje me tabelën e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak.*

*Punët që do të kryejë punëmarrësi janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit si dhe në kontratë si më poshtë vijojnë:*

- 1. Të kujdeset për mbarëvajtjen dhe menaxhimin e ujësjellësit në segmentin Kokërdhok – Trajë – Blad;*
- 2. Të bëjë manovrimet e rrjetit;*
- 3. Të bëjë leximin e aparatit matës të ujit dhe faturimin e faturave të abonentëve për segmentin Kokërdhok – Trajë – Blad;*
- 4. Si dhe detyra të tjera sipas nevojave të punëdhënësit, që nuk janë në kundërshtim me ligjin“.*

Për sa më sipër, rezulton se pavarësisht faktit, që kontrata individuale e punës ka qenë me afat të caktuar, i cili përfundonte në datën **31.05.2017**, punëmarrësi E.D. ka vazhduar të punojë pa kontratë pune, pranë Njesisë Administrative Ulëz, deri në datën **02.07.2018**, datë në të cilën është miratuar Vendimi nr. 34, datë 02.07.2018, i Administratorit për emërimin e ankuesit në pozicionin “*specialist hidraulik dhe manovrator*“ pranë Njesisë Administrative Ulëz. Në vijim, Ujesjellës Mat sh.a. ka lidhur me ankuesin Kontratën Individuale të Punës nr. 749/1, datë 02.07.2018, me afat të caktuar, për pozicionin “*specialist hidraulik dhe manovrator*“. Afati i kësaj kontrate pune ka qenë me afat 3 muaj nga data **02.07.2018** deri në datën **02.10.2018**. Në nenin 29, pika 1, të kësaj Kontrate është parashikuar shprehimisht: “*Pasi punëmarrësi u njoh me rregulloren e brendshme të institucionit, detyrat dhe kompetencat e tij, të dy palët bien dakord dhe me dëshirë e vullnet të lirë miratojnë këtë kontratë pune për një periudhë 3 (tre) muajore nga data **02.07.2018** deri më datë **02.10.2018**. Në mbarim të afatit të sipërcituar, ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër”.*

Kontrata e sipërpërmendur e Punës për ankuesin E.D.nuk është rinovuar, pas përfundimit të saj në datën **02.10.2018**. Pavarësisht sa më sipër, ankuesi ka vazhduar në punojë pranë Ujesjellës Mat sh.a.

Në Vendimin nr. 27, datë 22.11.2019, të Këshillit të Administrimit të Ujesjellës Mat sh.a. është miratuar struktura e re organike e kësaj shoqërie. Referuar kësaj strukture rezulton se Ujesjellës Mat sh.a. ka në përbërjen e saj 7 (shtatë) hidraulikë dhe manovratorë dhe mirëmbajtës, kualifikimi, i të cilëve duhet të jetë i mesëm. Në vijim të miratimit të kësaj strukture, nëpërmjet Urdhërit nr. 52, datë 13.12.2019, të Administratorit të kësaj shoqërie, ankuesi E.D. është emëruar në pozicionin e punës “*hidraulik & manovrator & mirëmbajtës*“ në Njesisë Administrative Ulëz, Sektori Fshat në Drejtorinë Teknike pranë Ujesjellës Mat sh.a. Pas miratimit të këtij urdhëri, është vijuar me nënshkrimin e Kontratës Individuale të Punës nr.746/1, datë 13.12.2019, me afat të caktuar, për periudhën 3 muajore, **13.12.2019** deri në datën **13.03.2020**. Në nenin 29, pika 1, të kësaj kontrate është parashikuar shprehimisht: “*Pasi punëmarrësi u njoh me rregulloren e brendshme të institucionit, detyrat dhe kompetencat e tij, të dy palët bien dakord, dhe me dëshirë e vullnet të lirë miratojnë këtë kontratë pune për një periudhë 3 (tre) muajore nga data **13.12.2019** deri më datë **13.03.2020**. Në mbarim të afatit të mësipërm dhe nëse nuk bëhet njoftimi 5 ditë para përfundimit të afatit të mësipërm, kjo kontratë mbetet në fuqi edhe për një periudhë tjetër 9-mujore deri më datë **13.12.2020**. Në mbarim të afatit të sipërcituar, ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e*

afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër”.

Në përfundim të kësaj periudhe 3 mujore, punëdhënësi i ka dërguar Z. E. D. shkresën nr. 80, datë 09.03.2020, me lëndë “Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës“, e në vijim nëpërmjet Vendimit nr. 20, datë 17.03.2020 “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës“ të Administratorit të Shoqërisë, ndërmarrjen Ujësjiellës Mat sh.a ndërpret marrëdhënien e punës me z. E.D.me motivacionin “përfundim i afatit të kontratës së punës“.

Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar se gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës me Ujësjiellës Mat sh.a., z. E.D. ka punuar me kontrata me afat të caktuar 3 mujor, përkatësisht 3 të tilla, si më poshtë vijojnë:

1. Kontrata Individuale e Punës, nr. 428, datë 24.02.2017, me afat të caktuar nga data **24.02.2017** deri në **datën 31.05.2017**, ku rezulton se ankuesi E.D.ka filluar punë në pozicionin “punonjës shërbimi i pakualifikuar me kontratë të përkohshme” pranë Sektorit të Ujësjiellësit të Njësisë Administrative Ulëz;
2. Kontrata Individuale e Punës nr. 749/1, datë 02.07.2018, me afat të caktuar 3 mujor nga data **02.07.2018** deri në datën **02.10.2018**, për pozicionin “**specialist hidraulik dhe manovrator**“.
3. Kontrata individuale të punës nr.746/1, datë 13.12.2019, me afat të caktuar 3 mujor, nga data **13.12.2019** deri në datën **13.03.2020**, për pozicionin e punës hidraulik & manovrator & mirëmbajtës në Njësinë Administrative Ulëz, Sektori Fshat në Drejtorinë Teknike pranë Ujësjiellës Mat sh.a.

Në të tre kontratat e mësipërme parashikohej shprehimisht: “...Në mbarim të afatit të sipërcituar, ndërprerja e marrëdhënieve të punës bëhet pa njoftim paraprak në datën e përcaktuar më lart. Zgjatja e afatit të kontratës bëhet vetëm me kontratë të re, asnjë veprim tjetër i njëanshëm nuk përbën detyrim kontraktual për palën tjetër”.

Në këtë kontekst, rezulton se së fundmi marrëdhënia e punës ndërmjet Ujësjiellës Mat sh.a. dhe ankuesit, ka qenë e rregulluar nëpërmjet kontratës së punës me afat të caktuar, në kuptim të nenit 149, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Neni 149, pika 1, i ligjit të sipërcituar parashikon shprehimisht:

*“1. Kontrata me afat të caktuar përfundon në fund të kohës së parashikuar, pa zgjidhje paraprake.*

Ujësjetllës Mat sh.a., në përfundim të afatit të përcaktuar në kontratë, ka kryer të gjitha procedurat përkatëse të parashikuara në nenin 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, si pasojë e përfundimit të afatit kontraktor.

Neni 676, paragrafi 1, i Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar): parashikon: *“Kontrata quhet e lidhur, kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.”* Në këtë kontekst, në kushtet kur marrëdhënia e punës ndërmjet Ujësjetllës sh.a. dhe ankuesit ka përfunduar, Komisioneri gjykon se lidhja e një kontrate të re, pune ndërmjet dy palëve është një çështje, që lihet në çmimin dhe vullnetin e përbashkët të të dy palëve.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, ankuesi E.D. nuk është ekspozuar para një trajtimit të padrejtë e disfavorizues nga ana e Ujësjetllës Mat sh.a.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të z. E. D., për shkak të bindjes politike, nga ana e Ujësjetllës Mat sh.a.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DREJTORE JURIDIKE**

**Ardiana HALA**

Fusha – punësim  
Shkak – bindja politike  
Lloji i vendimit - mosdiskriminim